

UDHËZUES PËR TIK I  
METAMORFOZIS Nr. 9



LIRIA E SHPREHJES  
NUK ËSHTË  
LIRI E SHPREHJES  
SË URREJTJES




# 1. SI TA NJOH?

**G**juha e urrejtjes është gjuhë e anshme, armiqësore, keqdashëse e orientuar drejt një njeriu ose grupi njerëzish, për shkak të disa karakteristikave që i kanë ose që u përshkruhen se i kanë.

Gjuha e urrejtjes paraqet sjellje diskriminuese, kërcënuese, antagoniste, e cila shumë shpesh bazohet në paragjyqime ndaj njerëzve, për shkak të gjinisë së tyre, orientimit seksual, racës, fesë, përkatësisë etnike, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes kombëtare, ndonjë lloji të pengesës (mentale, intelektuale ose fizike).

Gjuha e urrejtjes ka për qëllim të lëndojë, ta paraqesë dikë si më pak njeri se sa të tjerët, të shqetësojë, të përbuzë, të nënçmojë, të degradojë dhe të nxisë pandjeshmëri dhe brutalitet ndaj grupeve të caktuara të njerëzve për shkak të karakteristikave të tyre.



URREJTJA MUND  
TË FLITET, TË  
VIZATOHET, TË  
KËNDOHET, TË  
SHKRUHET, ...



## 2. TË DREJTAT E MIA = TË DREJTAT E TUA = TË DREJTAT E TIJ/TË SAJ

### KAM TË DREJTË:

- ▶ Të marr dhe të jap informata
- ▶ Të marr pjesë dhe të ndikoj
- ▶ Të kontrolloj
- ▶ Të kërkoj
- ▶ Të kontestoj
- ▶ Të kundërvihem
- ▶ Të jem i ndryshëm/e ndryshme

**DHE TË GJITHË  
TË TJERËT I KANË  
TË DREJTAT E  
NJËJTA**

Kam të drejtë të vendos se çka më pëlqen, e çka jo, me çka pajtohem, e me çka jo, kë e përkrah, e kë jo. Kam të drejtë të jem së bashku me ata që kanë interesa, nevoja dhe dëshira të ngjashme si të miat.



**DHE TË GJITHË TË  
TJERËT I KANË TË  
DREJTAT E NJËJTA**

Kufiri i të drejtave të mia janë të drejtat e të tjerëve. Mund të mos më pëlqejnë, të mos i pranoj, mund të më duken qesharake ose të pakëndshme, por kjo nuk do të thotë se ata kanë më pak të drejta ose se kam të drejtë t'ua kufizoj të drejtat e tyre.

Të duhet atdheu nuk do të thotë se duhet të urrehen të gjithë ata që janë nga ndonjë shtet tjetër... Dashuria ndaj grupit të vet etnik nuk tregohet duke i urrejtur grupet e tjera etnike. Respektimi i fesë së vet nuk tregohet me urrejtje ndaj feve të tjera. Kur dëshiroj ta përkrah ekipin tim, si e bëj këtë - duke brohoritur porosi të dhunshme?

Nuk kam të drejtë për:

- ▶ Dhunë dhe thirrje për dhunë
- ▶ Shkelje të dinjitetit
- ▶ Frikësim
- ▶ Kufizim të të drejtave dhe lirive të të tjerëve
- ▶ Vështirësim të ushtrimit të të drejtave dhe lirive
- ▶ Krijim të mjedisit që vështirëson ushtrimin e të drejtave dhe lirive

## 3. A NUK MA KUFIZON NDALESA LIRINË?

GJUHA E  
URREJTJES E  
KUFIZON TË  
DREJTËN/LIRINË  
E TË SHPREHURIT

### GJUHA E URREJTJES I PENGON NJERËZIT:

1. Të japin dhe të marrin informata në bazë të të cilave do ta bëjnë zgjedhjen e tyre

Kur dikush i nënshtrohet kërcënimeve, talljes, nënçmimit, ai nuk do të dojë që të këmbëjë mendime, informata, pikëpamje.

Do të heshtë.


2. Të marrin pjesë dhe të ndikojnë në proceset e vendimmarrjes

Kur dikush frikësohet të thotë se çka mendon, të pyesë, të kundërvihet, ai nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

3. Ta kontrollojnë pushtetin

Kur dikush sulmohet për shkak se është i ndryshëm, për shkak se nuk pajtohet me vendimet e pushtetit, për shkak se ka mendim të ndryshëm nga pushteti, ai nuk mund t'i rishqyrtojë dhe të japë vlerësime për to.





**GJUHA E UR-  
REJTJES ËSHTË  
KEQPËRDORIM  
I LIRISË SË TË  
SHPREHURIT QË  
PËRBËHET NGA  
SHKELJA E TË  
DREJTAVE TË TË  
TJERËVE OSE E  
VËSHTRËSON  
USHTRIMIN E TË  
DREJTAVE TË TË  
TJERËVE**

4. Të kërkojnë (të drejta, informata, përgjegjësi, ...)

Kur dikush frikësohet, ndjehet i rrezikuar, për shkak se është i ndryshëm ose ndryshe i sheh gjërat, ai nuk do të ketë guxim të kërkojë informata, t'i kërkojë të drejtat e tij ose të kërkojë përgjegjësi prej dikujt.

5. Të jenë të ndryshëm

Kur dikush është i tallur për shkak të karakteristikave të tij, për shkak se është i ndryshëm, për shkak të mendimit të ndryshëm që e ka shprehur, ai do të provojë të jetë i njëjtë dhe t'i mohojë dallimet ose do t'i fshehë dallimet.

Ajo që është sfidë e vërtetë jetësore është të gjejmë mënyrë ta jetojmë të ndryshmen pa mos na bërë kjo dëm neve ose të tjerëve për rreth nesh. Është mirë ta themi mendimin tonë dhe atë se si ndjehemi, dhe çka na pëlqen, e çka jo. Mirëpo, atë liri duhet t'u mundësojmë edhe të tjerëve. Edhe kur nuk na pëlqen, edhe kur nuk pajtohemi me to edhe kur mendojmë se shumë gabojnë.

Për shkak se atje diku ekziston dikush, të cilit unë nuk i pëlqej dhe që mendon se unë jam shumë gabim dhe i cili aspak nuk pajtohet me mua.

## 4. SI PËRCILLET?

Shembuj të gjuhës së urrejtjes në internet.

Mund t'i shihni në tërësi në: <http://nemrazi.mk/primeri>.

### FAQET E INTERNETIT

“Nëse veten tuaj e konsideroni jobesimtare, ateiste, nëse mendoni se duhet të jetoni jetë të shfrenuar, të mos keni fëmijë **ATËHERË ABORTI LIRISHT LE TË BËHET PËRDITSHMËRIA JUAJ!!!!** Vrasja e foshnjës paraqet shkelje të ligjit të Zotit dhe të njeriut, është kundër idesë për familje dhe martesë, kundër farës së natyrës njerëzore, kundër popullit të vet dhe gjithë njerëzimit. Vrasja e fëmijëve është koncentrimi i egoizmit, vrazhdësi, burracakëri dhe dyfytyrësi.”

### RRJETET SOCIALE


„Vëlla, fshije këtë që na ofendon, përndryshe xhengiz ne nuk mund të jemi të mirë me dikë që nuk i takon fesë, gjakut, nacionalitetit tonë, nuk do të jem i mirë në vendin tim, për shkak se ky vend është i imi dhe si të dua ashtu do t'i trajtoj, për shkak se kur do të bëj dallim ndërmjet maqedonasit tonë, i cili i ngjan njeriut dhe ndonjë bastardi prej tyre që është bërë me incest, që i vjen era qengj, nuk mund të pajtohen, a e ke të qartë këtë”

### BLOG-ET

“Bëhet fjalë për mercenarë të huaj që do ta shisnin nënën, fëmijë dhe shtetin e vet për dollarë të gjelbër. Ata janë **MERCENARË**. Fundërinë e çdo shoqërie. Ulcera dhe qelbe të një vendi. Këlbazë e një populli. Këlbaza largohet me të kollitur, qelbi shtypet dhe largohet, ulcera largohet me intervenim kirurgjik. Me bistori, me thikë të mprehtë.”

### LOJËRAT

#### GAMBIT HateSpeechPROJECT



Shembuj të gjuhës së urrejtjes në internet.

Mund t'i shihni në tërësi në: <http://nemrazi.mk/primeri>.

#### FORUMET

“Pederastët morën hov të madh në vend, madje filluan ta dalin edhe me komunikata, çka mendoni ju për këtë dukuri në vend? Qëndrimi i tifozeve nëpër botë për këtë çështje është i njohur shumë mirë. Kjo temë duhet të merret seriozisht pa tallje, të mos lejojmë këta njerëz të sëmurë të na shëtisin nëpër rrugë”

#### KËNGËT



#### FJALIMET POLITIKE



Urrejtja më lehtë shprehet kur je anonim. Ndonjëherë përdorim fjalë dhe shprehje, peshën e të cilave nuk e kuptojmë për shkak se janë “in” për shkak se duken interesante, për shkak se të tjerët qeshin kur i përdorim.

Mirëpo, liria e madhe të cilën na e ofron interneti nënkupton edhe përgjegjësi të madhe. Ai është vendi ku mund ta themi atë që mendojmë pa u frikësuar se dikush do të na përqeshë, të jemi ata që jemi ose ata që duam të jemi. Dhe duam, ajo hapësirë të mbetet e tillë. E hapur dhe e sigurtë për të gjithë. Nëse dikush fillon të përdorë gjuhë të urrejtjes dhe me këtë e bën hapësirën e internetit të pakëndshme për disa njerëz, është vetëm çështje kohe kur do të paraqiten ata që do ta bëjnë këtë hapësirë të pakëndshme edhe për vetë atë.




## 5. KUSH MUND TË JETË CAK I GJUHËS SË URREJTJES?

Çdokush mund të jetë cak i gjuhës së urrejtjes, mirëpo disa njerëz më shpesh janë cak i gjuhës së urrejtjes, disa njerëz është më lehtë të jenë cak i gjuhës së urrejtjes.

Njerëzit që u takojnë grupeve të lëndueshme shumë më shpesh, më lehtë dhe më intensivisht janë cak i gjuhës së urrejtjes.

*Nëse jetoj në mjedis në të cilin shumica janë pjesëtarë të fesë ortodokse, askush nuk do të më qortojë nëse muslimanët i thërras me emra të shëmtuar.*

*Nëse shoqërohen me pjesëtarë të një partie politike, të gjithë do të më përkrahin kur do t'i ofendoj pjesëtarët e partisë kundërshtare.*



**Grupet e lëndueshme:**  
njerëz, të cilëve, për shkak të disa karakteristikave të tyre, më lehtë mund t'ua shkelësh të drejtat, pa pasur pasoja për këtë, pa u akuzuar nga rrethi dhe pa u ndjerë fajtor



*Askush nuk do të ma zë për të madhe nëse ata që janë të varur nga substancat psikotropike i quaj - narkomanë, pjesëtarët e pakicave heteroseksuale - të sëmurë nga sida, ndërsa kundërshtarët e abortit - vrasës.*

Gjuha e urrejtjes mund të jetë e orientuar kundër meje:

- ▶ kur i takoj ndonjë grupi që i është nënshtruar gjuhës së urrejtjes,
- ▶ kur njerëzit mendojnë se i takoj grupit që i është nënshtruar gjuhës së urrejtjes,
- ▶ kur përkrah ndonjë grup që i është nënshtruar gjuhës së urrejtjes,
- ▶ kur njerëzit mendojnë se përkrah ndonjë grup që i është nënshtruar gjuhës së urrejtjes,
- ▶ kur shoqërohem me dikë që i takon ndonjë grupi që i është nënshtruar gjuhës së urrejtjes
- ▶ kur nuk u bashkangjitem atyre që e përhapin gjuhën e urrejtjes
- ▶ kur iu kundërvihem atyre që e përhapin gjuhën e urrejtjes
- ▶ ...

## 6. KUR FLAS ME URREJTJE MUND TË PRES PËRGJIGJE QË ËSHTË URREJTJE

E dijmë se si duket kur dikush na ofendon, na lëndon, na nënçmon, na përqesh, na përbuz.

Kur dikush përqeshet, ofendohet, lëndohet për shkak të asaj që e ka thënë, në të ardhmen nuk do ta thotë atë që e mendon, nuk do të mundohet të marrë pjesë, nuk do të ndikojë.

Kur dikush përqeshet, ofendohet, lëndohet për shkak të asaj që e ka thënë, do të urrejë dhe do të dojë të kundërvihet. Do të dojë të ofendojë, lëndojë, nënçmojë, përqeshë, përbuzë.



#mosurrej

## 7. HESHTJA ËSHTË PJESËMARRJE

Kur do të përdoret gjuha e urrejtjes, heshtja paraqet pajtim me atë që përdor gjuhën e urrejtjes, heshtja bëhet përkrahje për atë që është thënë. Shpeshherë heshtim për shkak se kjo është më e thjeshtë dhe më e lehtë. Ndonjëherë heshtim për shkak se frikësohemi. Mirëpo, në qoftë se mendojmë se ajo që thuhet nuk është në rregull, e nga ana tjetër e zgjedhim heshtjen, në fakt bëhemi pjesë e përhapjes së gjuhës së urrejtjes. Gjuha e urrejtjes bëhet normale dhe e pranueshme, dhe bëhet pjesë e mënyrës së veprimit të përditshëm.

Vetëm kundërvënia aktive paraqet mospranim.

Vetëm kundërvënia aktive mund ta pengojë përhapjen e urrejtjes dhe mund t'i mbrojë ata që janë cak i urrejtjes.

Gjithmonë duhet t'i kundërvihem gjuhës së urrejtjes kur i jam ekspozuar asaj, ose kur dikush tjetër i është ekspozuar asaj. Nuk është patjetër që vet t'i kundërvihem gjuhës së urrejtjes. Mund të kërkoj ndihmë, këshillë, dhe përkrahje dhe duhet të jap këshillë, ndihmë dhe përkrahje. Me rëndësi është që të tregoj se nuk pajtohem, se nuk më vjen mirë, se nuk mendoj se është për të qeshur, se nuk e përkrah atë. Zëshëm dhe qartë.

DUHET TË  
REAGUJ



## 8. REAGO NDAJ GJUHËS SË URREJTJES

Gjuha e urrejtjes më së shumti është e pranishme kur askush nuk i kundërvihet asaj. Për shkak se dhunuesit shpeshherë janë edhe qyqarë, ata shpeshherë tërhiqen me shenjën e parë të rezistencës. Këto janë vetëm disa nga mundësitë, për të cilat më tepër mund të lexosh në pjesën “Udhëzime” në ueb-faqen “Mos urrej” ([mosurrej.mk/category/udhezuesit](http://mosurrej.mk/category/udhezuesit)).


Denoncimi i veprës penale në polici ose në Prokurorinë publike. Sipas Kodit penal të RM-së, përhapja e urrejtjes është veprë penale për të cilën pason dënim prej 1 deri në 10 vjet burg. Në MPB kjo mund të denoncohet edhe në mënyrë anonime, në stacionin më të afërt policor, nëpërmjet telefonit 192 ose në Departamentin për kriminalitet kompjuterik nëpërmjet e-mail-it: [cybercrime@moi.gov.mk](mailto:cybercrime@moi.gov.mk).

Fshirja e grafitëve që përhapin urrejtje

Në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter

- ▶ Përgjigja në postet ose tweet-et që përhapin urrejtje, duke ia bërë me dije autorit se çka është duke bërë, si dhe përdorja e hashtag-ut #mosurrej.
- ▶ Shfrytëzimi i mekanizmave për denoncim “me buton” që ofrohen nga media.





Në ueb, kontribuoni për demaskimin e gjuhës së urrejtjes edhe duke e denoncuar atë nëpërmjet:

- ▶ Shërbimit për verifikimin e fakteve në medime ([verifikimiifakteve.mk](http://verifikimiifakteve.mk)) nëpërmjet opcionit “Propozo artikull për recension”
- ▶ Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë ([znm.org.mk](http://znm.org.mk)) ose Këshillit për etikë në mediat në Maqedoni.
- ▶ Platformës [govornaomraza.mk](http://govornaomraza.mk).
- ▶ Opcionit “Denonco gjuhën e urrejtjes” në [bezomrazno.mk](http://bezomrazno.mk).



## mosurrej.mk

**Ueb-faqja mosurrej.mk** mbledh dhe prezanton informata dhe përmbajtje arsimore që kanë të bëjnë me luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Si pjesë e iniciativës kundër gjuhës së urrejtjes në internet të inicuar nga fondacioni Metamorfozis, FAR-i, Reaktor-i dhe Qendra për media të reja në vitin 2012, ai ofron mundësi për kyçjen e të rinjve në komunitetin e aktivistëve nga e gjithë Maqedonia.

Bashkangjituni edhe nëpërmjet Facebook-ut ([fb.me/nemrazi](https://fb.me/nemrazi)) dhe Twitter-it ([@nemrazi](https://twitter.com/nemrazi) dhe [@mosurrej](https://twitter.com/mosurrej) dhe [#nemrazi](https://twitter.com/mosurrej), gjegjësisht [@mosurrej](https://twitter.com/mosurrej) dhe [#mosurrej](https://twitter.com/mosurrej))

„Udhëzuesi i nëntë për TIK” i fondacionit “Metamorfozis” u dedikohet të rinjve nga Maqedonia, me qëllim që t’u ndihmohet ta njohin dhe t’i kundërvihen gjuhës së urrejtjes, në internet dhe oflajn.

Ky botim, si dhe të gjithë udhëzuesit e deritanishëm që i ka botuar fondacioni “Metamorfozis” janë në dispozicion në formë elektronike në ueb-faqen e fondacionit, si dhe në [mosurrej.mk](http://mosurrej.mk).

Versioni në formë të shtypur është pa pagesë, ndërsa kopje plotësuese mund të merrni nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë.

#### Botues:

Për botuesin: **Bardhyl Jashari**

Autore: **Mirjana Najcevska**

Përkthyes: **Valon Abdiu**

Logo: **Violeta Kocev**

Përgatitja grafike: **Koma**

Autori dhe fondacioni “Metamorfozis” janë pronarë të të drejtave autoriale të teksteve të publikuara në këtë udhëzues.



Në formë digjitale, përmbajtjet janë publikuar me licencën Creative Commons-  
Thekso burimin-Shpërndaj nën kushte të njëjta 2.5 Maqedoni

<http://creativecommons.org/licenses/by-sa/2.5/mk>

Përkrahur nga



**CIP** - Каталогизacija во публикаcija

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје  
342.727:172.12(036)

NAJCEVSKA, Mirjana

Liria e shprehjes nuk është liri e shprehjes së urrejtjes / [autore Mirjana Najcevska ; përkthyes Valon Abdiu]. - Shkup : Fondacioni Metamorfozis, 2014.  
- 15 стр. : илустр. ; 16x16 см

ISBN 978-608-4564-47-8

а) Говор на омраза - Граѓанска етика - Јавен морал - Водичи б)

Слобода на изразување - Злоупотреба

COBISS.MK-ID 96390410

## METAMORPHOSIS

“Metamorfozis” është fondacioni i pavarur, jopartiak dhe joprofitabil me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë. Misioni i fondacionit “Metamorfozis” është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës nëpërmjet zbatimit dhe përhapjes inovative të dijes. Vlerat e saj kryesore janë të qenit të hapur, barabarësia dhe liria.

Adresa për kontakt:

“Metamorfozis”

Rr. “Apostoll Gusllarot” nr. 40,  
1000 Shkup, Maqedoni

tel/faks: **+389 2 3109 325**

[info@metamorphosis.org.mk](mailto:info@metamorphosis.org.mk)

[www.metamorphosis.org.mk](http://www.metamorphosis.org.mk)

#mosurrej  
mosurrej.mk

